
Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

DORACAK PËR PROFESIONISTËT LOKAL PËR PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE LGBTI+ NË KOMUNITETET E TYRE



Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “© Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t’i drejtohen Divizionit të Këshillit të Evropës për Përfshirjen dhe Luftën Kundër Diskriminimit, Avenue de l’Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00, E-mail: Horizontal.Facility@coe.int © Këshilli i Evropës, Nëntor 2021.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Ky doracak është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës pale.

PASQYRA E LËNDËS

1. Hyrje..... faqe 3
2. Njohja e terminologjisë nga ana e profesionistëve lokal si pjesë e rëndësishme e procesit të afrimit me komunitetin faqe 4-7
3. Rëndësia e shërbimeve afirmuese dhe sfidat e profesionistëve në ofrimin e shërbimeve afirmuese faqe 8-9
4. Mitet dhe faktet për personat LGBTI+. faqe 10-11
5. Udhëzime për profesionistët se si të sfidojnë homofobinë e pranishme në komunitetet e tyre..... faqe 12-13
6. Të folurit në kontekste tradicionale dhe jo miqësore për të drejtat e personave LGBTI+. faqe 14-20

1. - Hyrja

Pse është e rëndësishme të flasim për të drejtat e personave LGBTI+ në komunitetet tona ?

Komuniteti LGBTI+ është një pjesë e rëndësishme dhe e pamohueshme e shoqërisë sonë. Vitet e fundit, për shkak të lëvizjeve që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin mbi të drejtat e komunitetit LGBTI+, shoqëria, profesionistët dhe institucionet mund të kenë më shumë informacion në raport me më përpara. Krahasuar me disa vite më parë, sot flitet në media, në shkolla, në institucione, në komunitete për komunitetin LGBTI+ . Megjithatë, shumë nga diskutimet në lidhje me personat LGBTI+, vazhdojnë të jenë të ngjyrosura me qëndrime paragjyquese dhe stereotipizuese.

Personat LGBTI+, shumë prej të cilëve jetojnë në fshehtësi të plotë për shkak të frikës, mbeten të izoluar nga shërbimet, ndihma dhe mbështetja. Kjo për shkak të stigmës, paragjyqimeve , diskriminimit, dhunës dhe abuzimeve. Jo rrallë herë, ky komunitet mbetet edhe larg vëmendjes së profesionistëve, të cilët nga ana tjetër hasin sfida në ofrimin e shërbimeve për një grup i cili përjeton nivel diskriminimi shumë të lartë.

Ky doracak synon të ndihmojë profesionistët të trajtojnë tema të rëndësishme me të rinjtë e komuniteteve lokale ku ata jetojnë, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për sfidat e personave LGBTI+. Diskutimet në komunitetet lokale për të drejtat e personave LGBTI+ mund të ndihmojnë në tre nivele:

-**Të rinjtë**- për të pasur një kuptueshmëri më të gjërë rreth të drejtave universale dhe të patjetërsueshme që gëzon secili individ . Do të zgjeronte informacionin e tyre mbi çështjet LGBTI+ gjë e cila mund të kontribuojë në uljen e paragjyqimeve dhe diskriminimit.

- **Profesionistët** – për të dalë në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut, duke krijuar besim në komunitet që profesionisti është një advokues i të drejtave të secilit, dhe sidomos të atyre që ndihen më të përjashtuar. Duke trajtuar tema gjithëpërfshirëse, profesionistët perceptohen më të besueshëm, jogjyqes, mbështetës. Kjo mund të ndihmojë personat LGBTI+ që t'u drejtohen për ndihmë ofruesve lokalë.

- **Personat LGBTI+** - për të jetuar një jetë ku të drejtat e tyre respektohen, ku trajtohen me dinjitet dhe respekt dhe marrin shërbimet dhe trajtimin si çdo qytetar tjetër i Republikës së Shqipërisë.

2. Njohja e terminologjisë nga ana e profesionistëve lokal si pjesë e rëndësishme e procesit të afrimit me komunitetin

Duhet theksuar se njohja e termave ndihmon në punën me të rinjtë LGBTI+, pasi krijon një ambient përfshirës ku personi LGBTI+ ndihet i kuptuar nga profesionisti. Kjo mund të ulë barrierat e personave LGBTI+ për të kërkuar ndihmë tek profesionistët. Në vijim do ju prezantojmë një sërë termash që lidhen me personat LGBTI+.

LGBTI: Ky është akronimi për “lezbike, gej, biseksual dhe transgjinator”. Duhet të kemi parasysh që me kalimin e kohës dhe me zhvillimet që shoqëria dhe gjuha pëson, kjo listë akronimesh është pasuruar dhe zgjeruar. Lezbike: Një grua ose vajzë e cila tërhiqet emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga një grua tjetër.

Gej: Një mbiemër që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën “homoseksual” kur i referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë. Biseksual: Individët që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dyja sekset. Nuk supozon ose hamendëson jo-monogami. Disa njerëz identifikohen si “bi” në vend të biseksualë.

Transgjinator: Termi transgjinator përdoret si një term ombrellë për personat që e ndjejnë ose e shprehin gjininë e tyre ndryshe nga pritshmëritë e shumicës bazuar në seksin e tyre biologjik. Ky grupim mund të përfshijë personat transeksualë ose ata që vishen ‘ndryshe’.

Transeksual: Ky term përdoret për persona të cilët duan të jetojnë / t’i përkasin një gjinie të ndryshme nga ajo që u është përcaktuar kur lindën. Këta persona mund të kërkojnë ndihmë mjekësore duke marrë hormone ose kryer ndërhyrje kirurgjikale për të jetuar sipas gjinisë me të cilën ata identifikohen. Në të shumtën e rasteve, ndjesia e përkatësisë në gjininë e kundërt nga ajo e regjistruar në lindje përjetohet gjatë të gjithë jetës.

Tranvestit: Ky është një term i papërshtatshëm, i cili konsiderohet ofendues për shumë njerëz. Në të kaluarën, ky term përdorej kryesisht për burra të cilët visheshin dhe silleshin si gra për qëllim të përfitimit emocional ose seksual.

Queer: Është një fjalë që njerëzit e përdorin për të përshkruar identitetin e tyre gjinor i cili nuk konformohet me standartet sociale dhe normat tradicionale të gjinisë. Queer mund të vetëquhen personat gej, lesbike, biseksual, straight etj.

Interseks: Interseksualiteti është një term ombrellë për personat që lindin me ndryshime në karakteristikat gjinore, kromozome dhe/ose hormone, të cilat mund të mos përkojnë me pritshmërinë shoqërore dhe mjekësore. Më konkretisht, personat interseksualë lindin me karakteristika fizike ose biologjike të gjinisë (si anatomia seksuale, organet riprodhuese, strukturat hormonale dhe/ose strukturat kromozomale) që nuk përputhen me përkufizimet

tipike për trupat e meshkujve ose të femrave. Ndonjëherë, kur lind një bebe, ajo lehtësisht mund të identifikohet si interseksuale nga karakteristikat trupore. Ka raste që foshnjat interseksuale kanë organe gjenitale të jashtme që duken qartësisht si organe femërore ose mashkullore, por organet gjenitale të brendshme mund të jenë të ndryshme, të keqformuara ose mund të mungojnë. Ndaj, në disa raste, një trup interseksual mund të zbulohet gjatë fëmijërisë, në pubertet, madje edhe gjatë jetës si i rritur.

Heteroseksual: Ky term u referohet personave të cilët tërhiqen emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga persona të seksit të ndryshëm.

Homoseksualiteti: Homoseksualiteti është tërheqja fizike, emocionale ose seksuale ndaj personave të të njëjtit seks. Duke qenë se ky term është lidhur me shumë stereotipe negative dhe paragjykime në shoqërinë tonë, termat gej ose lezbike janë më shumë të rekomanduar kur i referohemi personave të cilët tërhiqen nga i njëjti seks.

Homofobi: Ky term i referohet frikës, zemërimit, urrejtjes, mostolerimit dhe mospranimit të personave LGBTI.

Homofobi e brendësuar (interiorizuar): Homofobia e brendësuar dhe shtypja ndodh tek personat homoseksual, lezbike, biseksualë, dhe madje edhe heteroseksualëve, të cilëve i është mësuar se heteroseksualiteti është normë dhe "mënyra e saktë e të qenurit". Personat LGBTI në disa raste përvetësojnë mesazhet negative që pjesa tjetër e shoqërisë projekton ndaj tyre. Disa persona LGBTI vuajnë nga shqetësime mendore, si rezultat i kësaj.

Dalja hapur / Dalja nga dollapi: Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe pranimit të orientimit jo-heteroseksual ose identitetit gjinor me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Fillimisht, shumë të rinj LGBTI, krijojnë barriera emocionale kundrejt të njohurve të tyre, miqve dhe familjarëve duke pretenduar (konkretisht ose nëpërmjet heshtjes) se janë heteroseksualë. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proces jo linear. Termi i daljes nga dollapi është marrë dhe përkthyer direkt nga gjuha angleze duke qënë se në shqip nuk ekziston një term i tillë.

Seksi biologjik: Seksi biologjik i referohet ndarjes së njerëzve në meshkuj dhe femra bazuar në disa karakteristika biologjike, të tilla si: kromozomet, hormonet, ose organet gjenitale.

Shprehje gjinore - i referohet mënyrave se si shprehet gjinia, zakonisht përmes pamjes, veshjes, manierizmave etj. Shprehja gjinore bazohet te normat kulturore dhe ndryshon në vende dhe kontekste të ndryshme. Zakonisht është një zgjerim i identitetit gjinor, mënyra që ka dikush për të qenë burrë, ose grua.

Identiteti gjinor: Ky term i referohet përjetimit të brendshëm psikologjik të gjinisë tek një person; gjini e cila mund të përputhet ose jo me seksin e regjistruar pas lindjes. Identiteti gjinor është i ndryshëm nga orientimi seksual.

Rolet gjinore: Rolet gjinore janë seti i roleve dhe sjelljeve të lidhura me të qenit femër ose mashkull nga një shoqëri e caktuar. Rolet gjinore, pra mënyra se si shoqëria pret se duhet të sillet dhe të ndihet një femër dhe një mashkull, janë të ndryshme në kultura të ndryshme por dhe në periudha kohore të ndryshme.

Orientimi seksual: Tërheqje seksuale e natyrshme. Prirja ose aftësia për të zhvilluar marrëdhënie intime emocionale ose seksuale me njerëz që i përkasin të njëjtës gjini, gjinisë së kundërt apo më shumë se një gjinie. Ky term këshillohet të përdoret në vend të “preferencë seksuale” ose terminologjive të tjera jo të përshtatshme.

Parada e Krenarisë shpesh edhe Parada Gej: Event në të cilin komuniteti LGBTI+ dhe mbështetësit e tyre parakalojnë (shpesh duke ecur në këmbë) për të shprehur krenarinë e tyre të të qenurit gej, lesbike, transgjinorë, biseksualë. Krenaria për të dalë hapur gjatë këtij aktiviteti konsiston në faktin që komunitetit LGBTI+ i është dashur të luftojë me dekada për njohjen e te drejtave të barabarta si dhe për faktin që mos njohja e tyre si pjesë e barabartë e shoqërisë e ben këtë komunitet vulnerabël. Këto parakalime shpesh kanë formën e një feste por në mjaft raste ata janë thjesht parakalime apo manifestimeve simbolike për të kërkuar të drejtat themelore të cilat ju mohohen.

Rëndësia e Njohjes së Terminologjisë Ka dy aspekte të rëndësishme për të pasur parasysh rreth terminologjisë:

1. Gjuha që përdorni ka rëndësi.

2. Gjuha po evoluon në mënyrë të vazhdueshme.

Gjuha që ju përdorni ka rëndësi, sepse të qenit të kujdesshëm dhe përzgjedhja e fjalëve të duhura është një nga mënyrat më të thjeshta për të krijuar një mjedis të sigurt dhe pranues për personat me të cilët punoni. Brendësimi dhe përdorimi i kujdesshëm i termave më lart ndihmon personat LGBTI+ për të cilët ju kujdeseni për t’ju identifikuar si një person të hapur dhe pranues me të cilin mund të ndajnë ndjenjat e tyre dhe në të cilin mund të mbështeten. Si për çdo aspekt tjetër, gjuha e kujdesshme dhe e saktë duhet të reflektohet jo vetëm në atë të folur, por dhe në gjuhën që përdoret në mbajtjen e dokumentacionit, ofrimin e këshillave gjatë mbështetjes së një rasti ose diskutimin e tematikave të ndryshme në mënyrë që ajo të jetë gjithëpërfshirëse. Teksa lexoni termat më lart, kini parasysh që kjo listë nuk është shtruesë, duke qenë se gjuha dhe shoqëria në të cilën jetojmë është gjithmonë në evoluim. Nëse gjatë punës suaj ju përballeni me një term të ri, merrni pak kohë për ta kontrolluar ose pyesni kolegët

tuaj për domethënien dhe sa e përshtatshme është të përdoret në ndërveprimet me personat LGBTI+.

3. Rëndësia e shërbimeve afirmuese dhe sfidat e profesionistëve në ofrimin e shërbimeve afirmuese

Profesionistët në punë e tyre , sjellin më vete sjellin me vete qëndrimet dhe parafgjakime të tyre rreth orientimit seksual dhe gjinisë. Kjo mund të bëhet edhe në mënyrë të pavetëdijshme dhe të paqëllimshme. Është e rëndësishme që profesionistët të jenë të vetëdijshëm për vlerat e tyre dhe sesi këto vlera ndihmojnë komunitetin me të cilin punojnë.

Për shkak të qëndrimeve jo profesionale dhe gjyqese të profesionistëve shpesh herë personat LGBTI+ hezitojnë të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje edhe në rastet ku ndihen të kërcënuar me jetë. Kjo për shkak të përvojave që mund të ketën pasur me ofruesit e shërbimeve më parë.

Është e rëndësishme që, pavarësisht sfidave të cilat përmenden më poshtë në këtë pjesë, profesionistët të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre të rëndësishëm që luajnë në ofrimin e mbështetjes dhe rëndësinë që ka qasja pranuese dhe miqësore ndaj personave LGBTI+ ndërkohë që ofrohen shërbime.

Një profesionist i trajnuar dhe mirëinformuar , do të ofronte shërbime të kujdeshëm dhe të plotë për personin që kërkon ndihmë , pa u penguar nga sfidat personale të cilat mund të pengojnë dhe dëmtojnë procesin.

Duhet thënë që në tërësi sfidat që hasin profesionistët në punën me fëmijët apo të rinjtë LGBTI+, janë pak a shumë të ngjashme me sfidat që ata hasin në punën me grupet e tjera vulnerable. Këto sfida të përfshijnë:

- Mungesën e shërbimeve ose përqëndrimin e shërbimeve vetëm në Tiranë. Kjo e bën të vështirë menaxhimin e rasteve të personave nga komuniteti LGBTI+, për shkak se shërbimet nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Për më tepër ofrimi i shërbimeve është ende një

- Një çështje tjetër është edhe mungesa e trajnimeve specifike të profesionistëve për punën me personat LGBTI+. Siç është theksuar më herët Përveç sfidave të profesionistëve që janë të ngjashme me sfidat e grupeve të tjera vulnerable, ka edhe vështirësi të tjera të cilat janë specifike për punën me komunitetin LGBTI+. Vetë profesionistët rriten të rrethuar nga gjuha homofobike dhe mospranuese ndaj komunitetit LGBTI+ e pranishme në familje, grupet shoqërore, media, institucione fetare etj. Për të reflektuar mbi këtë mendoni se sa herë keni dëgjuar komente homofobike apo komunikim të mospranimit të këtij komuniteti në ambjentet rreth e Udhëzues në praktikën me fëmijë dhe të rinj lezbike, gej, biseksualë/e dhe transgjinerë (LGBTI+) 53 rrotull ku ju jetoni? Fjali të tilla si ‘u sos bota’, ‘ngelen hallet e shqiptarëve te këta’,

‘sikur s’ka halle të tjera Shqipëria’, ‘duhen zhdukur’ - janë të pranishme në vazhdimësi në reagimin ndaj komunitetit LGBTI+. E gjitha kjo gjuhë urrejtje e pranishme masivisht në shoqërinë që rrethon profesionistin, e ndikon patjetër atë në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme në besimet, stereotipet apo paragjykimet që mbart. Profesionistët lokal (si psikologë, punonjës social etj) që gjatë punës së tyre mund të jenë në kontakt me fëmijë apo të rinj LGBTI+, mund të mbartin stereotipe që i shfaqin në këtë mënyrë:

- tregojnë se në qytetet kur jetojnë nuk ka fëmijë apo të rinj LGBTI+, Tregojnë se ‘shfaqje’ të tilla ndodhin vetëm në qytete të mëdha ose gjatë adoleshencës, duke mohuar ekzistencën e tyre ose duke nënkuptuar se homoseksualiteti është një “zgjedhje” momentale.

-Disa raportojnë se kjo temë nuk ka lidhje me ta, sepse ata punojnë me fëmijë LGBTI+ deri në 15 vjeç, Disa raportojnë se fëmijë apo të rinjtë LGBTI+, identifikohen lehtë që janë pjesë e komunitetit nga pamja apo sjellja e tyre.

-Disa raportojnë se të jesh gej është devijim apo sëmundje mendore.

4. Mite dhe Fakte

Është e rëndësishme të kuptoni se ju si profesionist, në përditshmërinë e punës suaj do haseni me mite të ndryshme për njerëzit që i përkasin komunitetit LGBTI+ dhe që nuk janë të vërteta. Stereotipet dhe paragjykimet ndaj këtij komuniteti vazhdojnë ti mbajnë këto dhe ti përforcojnë këto mite. Në aktivitetet e ndryshme ndërgjegjësuese që ju do mbani për promovimin e të drejtave të personave LGBTI+, do haseni shpesh me mite të tilla dhe është e rëndësishme që ato të adresohen.

<p>MIT #1</p> <p>Burrat gej ngacmojnë fëmijët më shumë sesa burrat heteroseksualë</p>	<p>FAKTE</p> <p>Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologëve, nuk ka evidenca që fëmijët ngacmohen më shumë nga personat LGBTI+ ose miqtë apo të njohurit e tyre LGBT. Një profesor në Universitetin e Kalifornisë, që është lider i studimeve mbi paragjykimet kundër minoriteteve seksuale, kreu një studim dhe nuk gjeti të dhëna se burrat ngacmojnë fëmijët më shumë sesa burrat heteroseksualë. Kjo përforcohet nga një kërkim i Nicholas Groth, pioner në fushën e abuzimit seksual të fëmijëve, që tregoi se kjo nuk është e vërtetë.</p> <p>Instituti i Studimeve dhe Parandalimit të Abuzimit të Fëmijës tregon se 90% e abuzuesve i targetojnë fëmijët në rrethin e tyre të familjes dhe fëmijëve, dhe pjesa më e madhe janë burra të martuar me gra.</p>
<p>MIT #2</p> <p>Prindërit e të njëjtës gjini e dëmtojnë fëmijën.</p>	<p>FAKT</p> <p>Nuk ka studime që kanë treguar se prindërit e të njëjtës gjini krahasuar me ata heteroseksualë e dëmtojnë fëmijën.</p> <p>Sipas Akademisë Amerikane të Pediatrisë në 2013 “një literaturë shkencore gjithmonë e më e madhe tregon se fëmijët që rriten me një ose dy prindër gej, rriten po aq mirë në funksionimin emocional, konjitiv, social dhe seksual sesa fëmijët me prindër heteroseksualë ». Sipas APA, stereotipet negative mbi prindërimin e personave LGBT nuk mbështeten nga të dhëna shkencore. Në një nga studimet më të mëdha botërore të vitit 2014, në Australi, tregohet se fëmijë të rritur nga prindër gej dhe lezbike rriten më të shëndetshëm dhe në familje që kanë kohezion më të fortë se ato heteroseksuale</p>
<p>MIT #3</p>	<p>FAKTE</p>

<p>Njerëzit bëhen homoseksualë sepse ata kanë qenë të abuzuar seksualisht kur ishin fëmijë ose për shkak të një mangësie të rolit gjinor të modeluar nga prindërit.</p>	<p>Nuk ka baza shkencore që e lidh orientimin seksual ose identitetin me rolin gjinor të modeluar nga prindërit ose abuzimin seksual në fëmijëri..</p> <p>Organizata Botërore mbi Viktimizimin Seksual Mashkullor shkruan se « ekspertët në fushën e seksualitetit njerëzor nuk besojnë se përvojate hershme seksuale luajnë një rol domethënës në adoleshencën e vonë ose orientimin seksual si i rritur » dhe shtojnë se nuk ka gjasa që dikusha bëj dikë tjetër gej apo heteroseksual.</p>
<p>MIT #4</p> <p>Asnjë nuk lind gej.</p>	<p>FAKTE</p> <p>Shkencat moderne nuk kanë arritur në përfundim se çfarë e nxit perkatesine ne nje orientim seksual te caktuar, por shumë studime sugjerojnë se vjen si rezultat i ndërveprimit të forcave biologjike dhe mjedisore, dhe jo e një « zgjedhje » personale.</p> <p>Shoqata Amerikane e Psikologëve (APA) citon se orientimi seksual « renditet në një kontinum », dhe njeh se pavarësisht shumë studimeve në ndikimet e mundshme gjenetike, hormonale, sociale dhe kulturore në orientimin seksual, shkencëtarët ende duhet të gjejnë shkaqet e orientimit seksual. Pavarësisht kësaj, APA citon se « shumë njerëz përjetojnë pak ose aspak zgjedhje rreth orientimit të tyre seksual.</p>
<p>MIT #5</p> <p>Njerëzit gej mund të zgjedhin që ta lënë homoseksualitetin.</p>	<p>FAKTE</p> <p>Të qenit LGBTI+ nuk është ‘zgjedhje’ ose diçka që të rinjtë mund ta ndryshojnë.</p> <p>Shoqatat kryesore të profesionistëve kanë njohur prej kohësh se orientimi seksual lezbik ose gej është një version normal i seksualitetit njerëzor dhe nuk është më shumë i luhatsëm për ndryshim sesa orientimi heteroseksual. Një person LGBTI+ asnjëherë nuk duhet t’i nënshtrohet terapive ‘riparuese’ me qëllim ndryshimin e orientimit ose identitetit të tij/saj seksual.</p>

5. Udhëzime për profesionistët se si të sfidojnë homofobinë e pranishme në komunitetet e tyre

Në takimet që ju bëni me anëtarë të ndryshëm të komunitetit ku ju veproni është e rëndësishme që ti pwrmbaheni disa parimeve qw lidhen me sfidimin e qwndrimeve homofobike. Disa prej kwytyre parimeve i kemi shpjeguar mw poshtw

1. Sfido qëndrimin homofobik dhe jo personin që ka qëndrimin homofobik

Nëse ju për shembull po mbani një takim dhe po flisni për të drejtat e njeriut dhe nga pjesmarrësit në takim ka komente homofobike, është e rëndësishme që në këto raste të mos e injoroni këtë gjë. Ta injorosh dërgon mesazhin e gabuar tek audienca që edhe ju bini dakord me komentin homofobik të mëparshëm. Nga ana tjetër, është gjithashtu e rëndësishme që të mos sulmoni apo sfidoni personin, por komentin homofobik që ai tha. Bëje të qartë që komentet homofobike apo çdo lloj komenti tjetër që sulmon grupe të caktuara mbi identitetin e tyre, nuk është i mirëpritur.

2. Prit që të ketë tension dhe konflikt dhe mëso ta menaxhosh atë

Çështje të tilla sensitive për njerëzit do ngjallin patjetër tension dhe konflikt dhe duhet thënë që nëse menaxhohet mirë, ky tension është i shëndetshëm pasi ndihmon në diskutimin e gjërave që njerëzit po mendojnë ndërkohë.

3. Ji i vetëdijshëm për qëndrimet, stereotipet dhe pritshmëritë

Ji i hapur për qëndrimet dhe pritshmëritë e tua, përfshirë qëndrimet homofobike që mund të keni pasur në të shkuarën për shkak të rritjes në një ambient homofobik. Jini të hapur ndaj paragjykimeve dhe stereotipeve tuaja. Është e rëndësishme të mos merrni një pozicion mbrojtës ndaj qëndrimeve diskriminuese që njerëzit vënë re tek ju.

4. Dëgjo në mënyrë aktive dhe mëso prej tjerëve

Përpigu të dëgjosh në mënyrë aktive. Mos minimizo apo moho shqetësimet dhe mënyrën se si ndihen njerëzit me të cilët ju po flisni në takim.

5. Përdorni gjuhë dhe sjellje që është përfshirëse

Është thelbësore që të përdorni gjuhë që është përfshirëse dhe jo përjashtuese.

6. Jepni informacion të saktë që sfidon stereotipet dhe qëndrimet paragjyquese

Kini parasysh që të keni informacion mbi çështjet LGBTI+. Njëkohësisht jini të vetëdijshëm për mitet paragjyquese (shih seksionet e mësipërme) që janë të pranishëm në komunitet për personat LGBTI+. Sfidojini këto mite duke sjellë të vërteta dhe fakte mbi personat LGBTI+.

7. Jini të vetëdijshëm për hezitimet tuaja

Jini të qartë që nuk është gjithmonë e lehtë që të ndërhyhet dhe të pranohen ndërhyrjet tuaja, sidomos në kontekste tradicionale siç janë kontekstet ku ju veproni. Nëse ju mundeni të sfidoni hezitimet dhe frikërat tuaja, atëherë do bëhet më e lehtë.

8. Krijoni një klimë të kuptuari, respekti dhe pranimi

Kur të konfrontoni dhe sfidoni personat që janë pjesë e takimeve tuaja, adresoni sjelljen apo qëndrimet e tyre homofobike, por kujdesuni për dinjitetin e personit.

6. Të folurit në kontekste tradicionale dhe jo miqësore për të drejtat e personave LGBTI+

Në shoqëritë tradicionale si e jona, ndryshimet në qëndrime marrin kohë. Ekspozimi ndaj informacionit, ndaj diversitetit, përfshirja në diskutime, njohja me realitetin , mund të ndihmojë që komunitete të akomodojnë qëndrime të reja.

Diskriminimi ndaj personave LGBTI+ bie në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me parimet themelore të të drejtave të njeriut të përshkruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Diskriminimi, dhuna , qëndrimet homofobike mbeten thellë të ngulitura në shumë kultura sidomos në kultura si e jona. Dhunues të këtyre të drejtave shpesh bëhen familja, qytetarët, shteti, profesionistët , dhe shoqëria.

Mbrojtja e personave LGBTI+ nga dhuna dhe diskriminimi nuk kërkon hartimin e ligjeve të reja apo parimeve të reja për të drejtat e njeriut, por zbatimin e asaj çfarë parashikohet më Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në traktate të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në nenin 15 të kushtetutë se republikës së shqipërisë theksohet se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe se Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Detyrimet themelore ligjore të shtetit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI+ përfshihen në 5 rekomandimet që UN përmbledh si më poshtë :

Mbrojtje nga dhuna, nënkupton trajtimin e akteve të dhunës ndaj komunitetit LGBTI+ si krime të urrejtjes , duke i hetuar me kujdes dhe vëmendje dhe ndjekur deri në fund. Është e rëndësishme që dhuna, keqtrajtimi , abuzimi i çdo llojë forme të shihet si një akt që dënohet nga ligji , është krim, dhe bie në kundërshtim me themelet e të drejtës së çdokujt për të të gëzuar një jetë pa dhunë dhe pa abuzim. Është e rëndësishme të theksohen karakteristika universal e të drejtë së së çdo njeriu për mbrojtje, dhe nëse dikush bie viktimë e dhunës për shkak të orientimit seksual , është shkelur një e drejtë themelore dhe përgjegjës për këtë është ai që e shkel këtë të drejtë. Komuniteti LGBTI+ gëzon të drejtën për t'u mbrojtur, si çdo qytetar tjetër, nga çdo komunitet tjetër në republikën e Shqipërisë.

Parandalimi të torturës dhe keqtrajtimit të personave LGBTI, duke përfshirë ekzaminimet fizike poshtëruese, e ashtuquajtura terapi "konvertimi" e cila në SHqipëri është e ndaluar me ligj ,

sterilizimi ose procedurat e panevojshme mjekësore të kryera për fëmijët dhe të rriturit pa pëlqimin e tyre. Të gjitha të mësipërmet bien në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe duhet ndaluar dhe hetuar çdo veprimtari e tillë.

Shfuqizimi i ligjeve që kriminalizojnë personat LGBT, duke arrestuar apo ndaluar individë në bazë të orientimit të tyre seksual ose identiteti gjinore.

Ndalimi dhe adresimi i diskriminimit në bazë të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikat gjinore duke miratuar legjislacionin dhe politikat përkatëse gjithëpërfshirëse. Sigurimi i aksesit jodiskriminues në shërbimet bazë, arsimin, punësimin, strehimin dhe kujdesit shëndetësor . luftimi i stigmës dhe diskriminimit , duke përfshirë trajnimin, edukimin dhe aktivitete ndërgjegjësuere për zyrtarët publikë dhe publikun e gjerë. Konsultimi me Personat LGBTI mbi legjislacionin dhe politikat që prekin të drejtat e tyre.

Ruajtja e lirisë së shprehjes, tubimeve paqësore dhe shoqërimit për LGBTI njerëzit. Çdo kufizim mbi këto të drejta duhet të jetë në përputhje me ato ndërkombëtare njerëzore ligji për të drejtat, duke përfshirë edhe mosdiskriminimin. Mbroni individët që ushtrojnë ushtrimet e tyre të drejtat për lirinë e shprehjes dhe lirinë e tubimit dhe shoqërimit paqësor, duke përfshirë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, nga aktet e dhunës dhe diskriminimit nga publiku zyrtarët dhe palët private dhe ndjekin penalisht akte të tilla kur ato ndodhin.

6.1 Të folurit në këndvështrimin e të drejtave të njeriut

- AKTIVITETI 1 : Kur shkelen të drejtat e njeriut

Realizmi : një grup me 8-20 të rinj(16- 25 vjeç) vijnë së bashku në një aktivitet ku do të flitet për të drejtat e njeriut. Profesionisti sjell histori rastesh ku të drejtat e njeriut nuk janë respektuar. Pasi prezanton rastin e pason diskutimin me pyetjet përkatëse. Pas diskutimit shton disa detaje mbi rastin. Dhe pyet serish të rinjte mbi këndvështrimin e tyre në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut.

Rasti që prezantohet

Erla është 17 vjeçe dhe jeton në një qytet shumë të vogël në veri të Shqipërisë. . Së fundmi ka pasur disa konflikte me prindërit. Ata e kanë përzënë nga shtëpia dhe gjendet në situatë rruge. Edhe shoqet nuk duan që Erla të qëndrojë tek to. Së fundmi ka pasur edhe një problem në shkollë. Mësuesja e letërsisë, mësuesja kujdestare, e ka kërcënuar që do marrë masa për ta përjashtuar nga shkolla sepse sjellja e saj është e papërshtatshme. Erla nuk bën gjëra të papërshtatshme, nuk cënon askënd, dhe i qëndron besnikë mënyrës se si ndihet.

-pyetje për grupin - Cfarë të drejtash shkelen në këtë rast?

pas diskutimit profesionisti shton detaje – Erla sapo u ka thënë prindërve që është lesbike. Edhe në shkollë mbron të drejtat e personave LGBTI+ dhe në një orë të letërsisë i tha hapur mësueses që pëlqente vajzat. Që atëherë mësuesja ngacmon dhe sulmon Erlën, madje një herë i ka thënë edhe që përpiku të ndryshosh sepse homoseksualizmi është sëmundje dhe mund të shërohet.

Pyetje për grupin- A ndryshoi këndvështrimi juaj për historinë e Erlës tani që dini pak më shumë?

- nëse po, çfarë ndryshoi?

Profesionisti lehtëson diskutimin dhe thekson në fund: Erlës i janë shkelur disa të drejta të cilat i diskutuam në fillim. Fakti që ajo është pjesë e komunitetit LGBTI+ e bën akoma më vulnerable në këtë rast që ti shkelen të drejtat dhe të mos marrë mbrojtjen që ajo meriton.

6.1.1 Të folurit në këndvështrimin e të drejtës për tu mbrojtur nga diskriminimi;

- Aktiviteti 2 : **Si diskriminojmë një person LGBTI+**

Realizimi : Një grup të rinjsh ftohet të flasin rreth krimeve të urrejtjes. Profesionisti sjell përkufizimin rreth krimit të urrejtjes “çdo sjellje kriminale/ sulm që motivohet nga armiqësia ose paragjykimet ndaj nje personi apo komuniteti për shkak të identitetit të tyre” ose më thjeshtë “ të sulmohet njerëzit për ato që janë “

Të rinjve u kërkohet që për 1 javë të hulumtojnë mediat e shkruara dhe gjejnë histori të krimeve të urrejtjes në vendin tonë.

Të rinjtë ndihmohet të kategorizojnë krimet e urrejtjes dhe sëbashku shihni sa nga këto krime janë kryer ndaj personave LGBTI+

Të rinjtë instruktohen t’i printojnë dhe ngjisin këto histori (krimet ndaj perosnave LGBTI+)në një poster të vetëm.

Të rinjtë pyeten :

- Cfarë te drejtash janë shkelur?
- Po nëse personi nuk do ishte pjesë e komunitetit LGBTI+ a do ishte viktimë e ketij krimi?
- Cfarë mund të bëjmë që të ndalojmë krimet e urrejtjes?

Të rinjtë e vendosin posterin në një vend publik të aksesuesëhm nga komuniteti lokal. Posterit i vihet një titull që përmbledh idenë e aktivitetit.

Aktiviteti 3- Eksplorimi i stereotipeve

Qëllimi i këtij aktiviteti është që të kuptohen stereotipet e pranishme tek pjesmarrësit në lidhje me personat LGBTI+. Ky si ushtrim është i vlefshëm sidomos në fillim të aktivitetit. Të lejosh të rinjtë që të shprehin në mënyrë të lirshme dhe anonime idetë e tyre është jashtëzakonisht shumë e rëndësishme, duke qënë se të rinjtë shpesh do jenë hezitues për të ndarë mendimet dhe ndjesitë e tyre nga frika semos do gjykohen nga facilitatori Ti provokosh që të jenë të ndershëm dhe ti mbrosh nëpërmjet anonimitetit, do ju japë informacion të vlefshëm që do ju ndihmojë që të keni një pasqyrë të qartë të paragjykimeve ndaj komunitetit LGBTI+ dhe mundësi që të sfidoni këto paragjykime.

Jepini secilit student disa fletë letre. Shpjegoni se do të shkruani vetëm një fjalë në tabelë dhe se ata thjesht duhet të shkruajnë fjalën e parë që ju vjen në mendje sapo të shohin fjalën. Sigurojeni grupin që, është e rëndësishme të respektohen njerëzit e tjerë në sallë, por në të njëjtën kohë ata mund të jenë plotësisht të qartë dhe të hapur sepse ky është qëllimi i ushtrimit. Shpjegoni se aktiviteti është i bazuar në anonimitet dhe se ata duhet të punojnë individualisht.

Shkruani fjalën "gej" në tabelë. Pyesni të rinjtë pjesmarrës në ushtrim: Çfarë i bën kjo fjalë që të mendojnë? Çfarë domethënie ka fjala për ata? Me çfarë e lidhin këtë fjalë?

Mblidhni fletët dhe përsërisni të njëjtin ushtrim me fjalën "lesbikë" dhe kështu me radhë fjalët 'transgjinator' dhe 'interseks'.

Lexoni fjalët një nga një duke krijuar një diagram. Mos censuroni asnjë prej fjalëve; këto janë mitet që janë të pranishme për personat LGBTI+ dhe sado të mos lejoni që ato të komunikohen të rinjtë përballë jush do i kenë këto mite. Kërkojuni të rinjve që gjatë leximit të fjalëve të mos japin informacion se cilat fjalë ishin të tyre. Nëse është e mundur, mbajini fjalët e dukshme gjatë gjithë sesionit(eve) tuaj.

Në fund të seksionit, si një mënyrë shumë e mirë për të vlerësuar të mësuarit e pjesmarrësve, duhet të ktheheni tek fjalët në tabelë dhe të nxisni një diskutim që sfidon të gjitha ato paragjykime apo mite false në lidhje me komunitetin LGBTI+.

Ftojini të rinjtë në fund që të përdorin atë që kanë mësuar dhe sugjeroni fjalë që duhen rishqyrtuar;

pyetini nëse ato bazohen në fakte dhe nëse janë thjesht përgjithësime të bazuara në qëndrime diskriminuese. Vetëm nëse janë fakte, mundën të mbeten në tabelë. Nëse një fjalë bazohet në stereotipe, paragjykime, përgjithësime apo gënjeshtër duhet të fshihet ose ti vihet përsipër një kryq.

Ky demonstrim vizual është i fuqishëm dhe thekson mesazhin se jo të gjitha idetë dhe opinionet tona janë të sakta dhe të vërteta gjatë gjithë kohës. Si qytetarë të përgjegjshëm është e domosdoshme që të jemi të ndërgjegjshëm për rreziqet që sjell stereotipizimi dhe përgjithësimi.

6.1.2 Të folurit nën këndvështrimin e mbrojtjes nga bullizmi homofobik

- AKTIVITETI 4 : **STOP bullizmit ndaj personave LGBTI+**

Realizmi : Një grup të rinjsh ftohet të flasin rreth pasojave të bullizmit. Ato ndahen në 2 grupe :

1. Pasojat afatshkurtra dhe
2. Pasojat afatgjata të bullizmit.

Të rinjtë bëjnë dy postera me formën e njeriut dhe në trup të secilit shkruhen pasojat . grupi diskuton sesi bullizmi ndikon jetën e këtyre dy njerëzve në të tashmen dhe në të ardhmen.

Të rinjtë pyeten : Po nëse personi do të ishte LGBTI+ a do të ndryshonte diçka? – të rinjtë ndrihmohen të shohin sesi bullizmi është më i lartë ndaj personave LGBTI+ dhe që ato që kanë shkuar shumëfishohen në rastin e personave LGBTI+

Të rinjtë ftohen që në grupe dyshe të marrin rolet përkatëse si tek posteri, njëri që rrefen pasojat afatgjata që ka lënë bullizmi dhe tjetri që rrëfen pasojat afatshkurtra që ka lënë bullizmi.

Të rinjtë pyeten si ndihen pas ushtrimit. Si ishte për to të vihen në pozita të dikujt që bullohet sistematikisht për shkak të orientimit?

Të rinjtë ftohen t'i ngjisin posterat në një vënd të frekuentuar nga komuniteti lokal.